



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 1562/2 Prot.

Durrës më, 5/10 /2023

V E N D I M

Nr. 60 Datë 5/10 2023

PËR

"MIRATIMIN E NUMRIT TË STUDENTËVE PËR AKTIVIZIMIN E PROGRAMEVE TË STUDIMIT" TË CIKLIT TË PARË, NË UNIVERSITETIN "ALEKSANDËR MOISIU"

Bazuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, neni 57, në mbështetje të të ligjit Nr. 80/2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.685, datë 25.08.2010, 25.08.2010 "Për riorganizimin e Universitetit "Aleksandër Mmoisiu" Durrës", të ligjit nr.8480, date 27.5.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjiale te administratës shtetërore dhe enteve publike", të Udhëzimit nr.10 datë 15.05.2019 "Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në Institucionet e Arsimit të Lartë", i përditësuar, të Urdhërit të përbashkët nr. 10, datë 10.07.2023 "Për miratimin e kalendarit për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në Institucionet e Arsimit të Lartë, për vitin akademik 2023-2024", Statutit dhe të Rregullores së UAMD-së, të Senatit Akademik, shkresës nr.702/1 prot., datë 2.10.2023, të Fakultetit të Biznesit, të shkresës nr.620/1 prot., datë 3.10.2023 të Fakultetit të Shkencave Politike Juridike, të shkresës 628/1 prot., datë 28.9.2023 i Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit, shkresës 1853 prot., datë 2.10.2023 i Fakultetit të Edukimit, Senati Akademik;

V E N D O S I:

1. Miratimin e numrit të studentëve për aktivizimin e programeve të studimit të ciklit të parë të studimeve, të cilët kanë jo më pak se 50% të numrit të studentëve të programit me numrin më të ulët të kuotave të miratuara me Vendim të Senatit Akademik nr.24, datë 2.05.2023 "Për miratimin e kuotave të pranimit të studentëve në programet e ciklit të parë të studimeve "Bachelor" si dhe programet e studimeve me karakter profesional, 2-vjeçar, në ciklin e dytë të studimeve Master i Shkencave dhe Profesional, si dhe në ciklin e tretë "Doktoratë" për vitin akademik 2023-2024 në UAMD".
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen:
 - Zv. Rektorët
 - Drejtuesit i Njesisë Kryesore
 - Drejtuesit e Njësive Bazë
 - Drejtoria e Sigurimit dhe të Standardeve të Cilësisë
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R

Prof. Dr. Ksëaneta SOTIROVSKI

